



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**RREGULLORE (QRK) Nr.19/2023**  
**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT RRETH ADMINISTRIMIT TË**  
**PRONAVE DHE ZBATIMIT TË SKEMËS VULLNETARE TË QIRASË TË**  
**AGJENCISË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË**  
**PRONËS<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Rregullorja (QRK) Nr.19/2023 për rregullat dhe procedurat rreth administrimit të pronave dhe zbatimit të skemës vullnetare të qirasë të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës është miratuar në Mbledhjen e 178-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 12/178 të datës 13.12.2023.

## **Qeveria e Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 21 i Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 15, paragrafi 10 të Ligjit Nr. 08/L-052 dhe në pajtim me Nenin 8, paragrafit 4, nënparagrafi 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, nr. 15, 12 shtator 2011),

Nxjerrë::

## **RREGULLORE (QRK) Nr.19/2023 PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT RRETH ADMINISTRIMIT TË PRONAVE DHE ZBATIMIT TË SKEMËS VULLNETARE TË QIRASË TË AGJENCISË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS**

### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen, rregullat dhe procedurat rreth administrimit të pronave dhe zbatimit të skemës vullnetare të qirasë të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejné për Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronave dhe palëve në lidhje me pronat e vendosura nën administrim dhe zbatimin e skemës vullnetare të qirasë.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Termat e përdorura në këtë rregullore, kanë këtë kuptim:

1.1. **“Pronë e administruar”** nënkupton pronën nën administrim të AKKVP-së;

1.2.“**Qiramarrësi**” nënkupton personin fizik apo subjektin i cili e merr në shfrytëzim dhe posedim pronën e dhënë me qira nga Agjencia në shkëmbim të pagesës;

1.3.“**Qiradhënësi**” nënkupton Agjencinë, e cila administron pronën të cilën Qiramarrësi e ka marrë në shfrytëzim apo posedim në shkëmbim të pagesës;

1.4.“**Parashtruesi i kërkesës për administrim**” nënkupton parashtruesin e suksesshëm të kërkesës, bartësin e të drejtës pronësore, antarët e ngushtë të familjes dhe trashëgimtarët të cilët kanë parashtruar një kërkesë të suksesshme për administrim apo të cilët më vonë i janë bashkangjitur procedurës;

1.5.“**Inspektim i pronës**” nënkupton vizitën në pronën e administruar nga Agjencia, me qëllim të identifikimit të shfrytëzuesve, dëmtimeve, mbjelljeve apo korrjeve të kulturave bujqësore, njoftimit me vendime apo veprime të institucioneve qendrore apo lokale, si dhe me çfarëdo veprimi jo ligjor që mund të ushtrohet brenda hapësirave të pronave të administruara;

1.6.“**Parashtruesi i suksesshëm i kërkesës**” nënkupton parashtruesin, kërkesa e të cilit është aprovuar me vendim të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe vendimit të Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme të Kosovës;

1.7.“**Antar i ngushtë i familjes**” nënkupton personat fizik sic është e percaktuar me legjislacionin në fuqi;

1.8.“**Pronë e braktisur**” nënkupton çdo pronë, të cilën pronari, bartësi i të drejtës pronësore apo shfrytëzimit, posedimit apo anëtarët e familjes së ngushtë të tij/saj kanë pushuar ta shfrytëzojnë, e cila është e zbrazët ose e uzurpuar; përjashtimisht në rastet e mungesës së përkohshme të bartësit të së drejtës pronësore apo shfrytëzimit.

1.9.“**Bartësi i të Drejtës së Pronësore apo Shfrytëzimit**” nënkupton paraqitësin e suksesshëm të kërkesës i cili ka kërkuar që pronën ta vendos nën administrim.

2. Termat tjerë të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin Nr. 08/L-052 për plotesimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

#### **Neni 4**

#### **Pranimi i kërkesave për administrim dhe vendosja e pronave nën-administrim**

1.Parashtruesi i suksesshëm i kërkesës, bartësi i të drejtës pronësore, antarët e ngushtë të familjes dhe trashëgimtarët të cilët pranojnë vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore, apo të cilët pranojnë njoftimin për zbatim, kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë për administrim;

2.AKKVP do të vazhdojë me administrimin e pronave dhe zbatimin e skemës së qirasë, mbi bazën e Ligjit Nr. 08/L-052 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës dhe kësaj rregullore;

3.Agjencia pas shqyrtimit të kërkesës në lidhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, bazuar në vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore, dhe pas inspektimit, nese prona i plotëson kushtet konform kësaj rregullore vendos pronën nën administrim.

## **Neni 5**

### **Refuzimi i kërkesave për administrim**

1.Agjencia do ta refuzojë kërkesën për administrim në rast se:

1.1.parashtruesi/ja i/e kërkesës nëse nuk parashtron dokumente brenda afatit prej 45 ditësh nga parashtrimi i kërkesës për administrim, për të dëshmuar se është antari i ngushtë i familjes së bartësit të të drejtës pronësore apo trashëgimtar i tij/saj;

1.2.gjatë inspektimit është konstatuar se prona është pyll;

1.3.gjatë inspektimit është konstatuar se prona është shpronësuar apo është ndërtuar çfarë do objekti apo rruge nga institucionet lokale apo qendrore të vendit;

1.4.prona shfrytëzohet nga një palë e tretë sipas një marrëveshje me parashtruesin e sukseshëm të kërkesës, bartësin e të drejtës pronësore, antarin e ngushtë i familjes ose trashëgimtarët;

1.5.prona është ri-poseduar nga bartësi i të drejtës pronësore;

1.6.objekti banesor ku gjendet prona është demoluar nga ana e institucioneve lokale apo qendrore;

1.7.gjatë inspektimit një palë e tretë pretendon se është pronar i pronës, duke parashtruar kontratë të vërtetuar të shitblerjes me bartësin e të drejtës pronësore apo trashëgimtarët e tij;

1.8.gjatë inspektimi konstatohet se në pronë janë ndërtuar objekte, varësisht nga destinimi;

1.9. në të gjitha rastet kur sipas dokumenteve në shkresa të lëndës është e pamundur të lokalizohet prona, ndërsa të dhënat e tilla nuk gjenden në zyrën përkatës kadastrale komunale apo Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ndërsa parashtruesit e sukseshëm të kërkesës, bartësi i të drejtës pronësore, antarët e ngushtë të familjes dhe trashëgimtarët nuk parashtrojnë dokumentet e tilla të nevojshme në një afat prej 60 ditësh nga njoftimi i Agjencisë për këtë.

2.Në të gjitha rastet e refuzimit të kërkesës për administrim Agjencia do të njoftojë parashtruesit e sukseshëm të kërkesës, bartësin e të drejtës pronësore, antarët e ngushtë të familjes dhe trashëgimtarët.

## **Neni 6**

### **Administrimi i Pronave**

1. Agjencia do të administrojë pronat përmes:

1.1. Inspektiveve të rregullat në pronë;

1.2. Dëbimit të shfrytëzuesve të paligjshëm;

1.3. Njoftimit të parashtruesit të kërkesës, në lidhje me gjendjen e pronës;

## **Neni 7**

### **Inspektimi i pronës**

1. Agjencia do të administrojë pronën përmes inspektimit, duke vizituar pronën së paku dy herë brenda një viti kalendarik. Gjatë vizitës zyrtarët përkatës do të inspektojnë detajisht pronën e administruar:

1.1. duke shikuar për shenja të shfrytëzimit jo ligjor, varësisht nëse kemi të bëjmë me pronë banesore, komerciale apo bujqësore;

1.2. duke shikuar për shenja të dëmtimit të pronës nëse kemi të bëjmë me pronë banesore apo komerciale;

1.3. duke shikuar për mbjellje apo korrje të kulturave bujqësore nëse kemi të bëjmë me pronë bujqësore;

1.4. duke marrë informata për ndonjë aktivitet të mundshëm të ndonjë institucioni në lidhje me pronën;

1.5. duke mbledhur të gjitha informatat e nevojshme për çfarëdo aktiviteti të ligjshëm apo të pa-ligjshëm në lidhje me pronën;

2. Agjencia mund të ndemarr inspektive shtesë edhe me kërkesë të parashtruesit të Kërkesës për administrim.

## **Neni 8**

### **Dëbimi i shfrytëzuesve jo ligjor të pronave nën administrim**

1. Nëse gjatë inspektiveve në pronat nën administrim të Agjencisë, konstatohet se prona është duke u shfrytëzuar apo vërehen shenja të qarta se prona mund të shfrytëzohet në mënyrë të jashtëligjshme nga persona fizik apo juridik, atëherë zyrtarët/et përkatës, duhet:

1.1. të njoftojnë njësitin e administrimit të pronave në lidhje me gjendjen në pronë;

1.2.të vendosin të dhënat e tilla në aplikacionin përkatës të Agjencisë, me qëllim të njoftimit të njësitit përkatës për lëshim të urdhërit për dëbim;

2.Dëbimi i shfrytëzuesve jo ligjor të pronës nën administrim duhet të kryhet në një afat sa më të shkurtë po jo më larg se 30 ditë nga vizita në pronë;

3.Njësi i administrimit të pronave duhet të mbikëqyr dhe koordinojë procesin largimit të shfrytëzuesve të paligjshëm të pronave nën administrim.

## **Neni 9**

### **Njoftimi i parashtruesit të kërkesës, në lidhje me gjendjen e pronës**

1.Agjencia ka obligim të njoftojë parashtruesin e sukseshëm të kërkesës në lidhje me gjendjen në pronë, nese i kërkohet nga parashtruesi i kërkesës për administrim në cilën do nga gjuhët zyrtare në Kosove që zgjidhet nga parashtruesi i kërkesës;

2.Në lidhje me kërkesën sipas paragrafit 1 të këtij neni, Agjencia mund të njoftojë parashtruesin e kërkesës përmes telefonit apo me shkrim duke i bashkangjitur edhe fotografite e vizitës në pronë;

3.Në të gjitha rastet kur parashtruesi i kërkesës për administrim, pretendon se prona është duke u shfrytëzuar paligjshem, atëher Agjencia do të kryejë një inspektim në pronë, me qëllim të vërtetimit të gjendjes, për çka edhe do të njoftojë parashtruesin e kërkesës;

4.Në rast se pas inspektimit të pronës në lidhje me paragrafin 3 të këtij neni, vërtetohet se prona është duke u shfrytëzuar në mënyrë të paligjshem, atëhere shfrytëzuesi/t do të dëbohen sipas procedurave të dëbimit, të aplikuara sipas kësaj rregullore dhe legjislacionit në fuqi në lidhje me dëbimin e shfrytëzuesve të paligjshem.

## **Neni 10**

### **Të drejtat dhe obligimet e parashtruesit të kërkesës për administrim**

1. Për sa kohë që prona është nën administrim, e drejta e posedimit të bartësit të së drejtës së pronësisë apo shfrytëzimit, pezullohet;

2. Për sa kohë prona është nën administrim parashtruesit e kërkesës për administrim, kanë të drejtë:

2.1.të kërkojnë ri-posedimin e pronës;

2.2.të kërkojnë largimin e pronës nga administrimi pa dëbim dhe me mbyllje të rastit;

2.3.të informohen në lidhje me dëmtimet e mundshme të kryera nga shfrytëzuesit e paligjshëm apo dëmtime të shkaktuara si pasojë e vjetërsisë;

2.4.të informohen në lidhje me veprimet ligjore të Agjencisë drejtuar institucioneve tjera në lidhje me shfrytëzuesit e paligjshëm.

3. Parashtruesit e kërkesës për administrim, janë të obliguar të njoftojnë Agjencinë nëse:

- 3.1.kanë hyrë në posedim të pronës;
- 3.2.kanë shitur pronën apo vetëm një pjesë të saj;
- 3.3.kanë lidhë marrëveshje qiraje me një palë të tretë;
- 3.4.apo nëse në çfarëdo forme, posedimin apo pronësin e kanë transferuar tek një palë tretë.

## **Neni 11**

### **Të drejtat dhe obligimet e Agjencisë në lidhje me pronat nën administrim**

1. Të drejtat dhe obligimet e Agjencisë në lidhje me pronat nën administrim janë si në vijim:

- 1.1.konsiderohet poseduese e pronës nën administrim;
- 1.2.ka të drejtë të kërkojë dhe mbledh informata në lidhje me pronën nën administrim, për sa i përket autorizimeve të saj, në lidhje me procesin e administrimit;
- 1.3.bën përpjekje të arsyeshme për ta minimizuar rrezikun e dëmtimit të çdo prone nën administrimin e saj por nuk mban kurrfarë përgjegjësie për asnjë dëmtim të pronës dhe as për humbjen apo dëmtimin e përmbajtjeve të saj;
- 1.4.ka obligim të sillet në raport me pronën nën administrim duke pasur parasysh interesin më të mirë të bartësit të së drejtës pronësore;
- 1.5.është e obliguar që në bazë të kërkesës të kthejë në posedim pronën, tek parashtruesi i kërkesës për administrim, përpos në rastet kur për shkak të veprimeve ligjore apo veprimeve tjera kthimi i posedimit është i pamundshëm;
- 1.6.është e obliguar të mbyll kërkesën dhe largojë pronën nga administrimi, mbi bazën e një kërkesë nga personat me të drejtë për një kërkesë të tillë sipas kësaj Rregullorje.

## **Neni 12**

### **Skema vullnetare e qirasë dhe dhënia e pronave me qira**

1. Të gjitha pronat nën administrim, ku parashtruesi i kërkesës për administrim, ka dhënë pëlqim në formën me shkrim për inkuadrim në skemë të qirasë, mund të ipen me qira nga Agjencia;
2. Njësitë përkatës të Agjencisë është e obliguar të mbajë një listë dhe të përditësoj atë, e cila duhet të përmbajë të gjitha të dhënat në lidhje me pronat në skemë të qirasë dhe në pritje për dhënie me qira dhe ta publikojë të njëjtën në faqen elektronike të Agjencisë, por edhe në forma të tjera të përshtatshme me qëllim të reklamimit të duhur;
3. Njësitë përkatës të Agjencisë është po ashtu e obliguar të përpilojë një listë të pritjes për qiramarrësit potencial, për secilën zyrë regjionale dhe komunë, bazuar në kërkesat për qiramarrje dhe komunat në të cilat ka prona në skemë të qirasë;

4. Pronat në skemë të qirasë, varësisht nëse janë në shfrytëzim mbi bazën e një marrëveshje qiraje ose jo, duhet të inspektohen sipas rregullave të inspektimit të pronave nën administrim;
5. Agjencia duhet të sigurohet se prona e dhënë me qira do të shfrytëzohet konform destinimit të pronës dhe nuk do të shfrytëzohet në atë mënyrë e cila do të zvogëlonte vlerën apo shkaktonte dëmtim në pronë;
6. Në lidhje me pronat në skemë të qirasë, Agjencia do të konsiderohet si qiradhënëse dhe përmes zyrtarëve të autorizuar, do të lidhë kontratën e qirasë me qiramarrësit;
7. Kontratat e qirasë mund të lidhen në afat prej 6 deri 12 muajve me mundësi vazhimi;
8. Me rastin e lidhjes së kontratës së qirasë, qiramarrësi është i obliguar të paguajë një depozitë, në lartësin e 2 qirave, në lidhje me dëmtimet eventuale;
9. Me rastin e lidhjes së kontratës Agjencia duhet të rezervojë të drejtën e shkëputjes së kontratës, brenda 1 muaji nga njoftimi i qiramarrësit;
10. Agjencia rezervon të drejtën e shkëputjes së menjëhershme dhe pa njoftim, të kontratës së qirasë, në të gjitha rastet kur konstatohet, se prona është duke pësuar dëmtim të vazhdueshëm si rezultat i keq shfrytëzimit nga ana e qiramarrësit.

### **Neni 13** **Lartësia e Qirasë**

1. Lartësia e qirasë përcaktohet në bazë të formulave, sic janë:

1.1. Prona komerciale dhe banesore:

$$(A * B * D * E + F - G) / 12$$

1.2. Prona bujqësore:

$$A * C * D * E * 12$$

1.3. *Siperfaqja (A)* e shfrytëzuar e pronës;

1.4. *Vlera e pronës (B)* siç është vlerësuar nga Departamenti i Tatimit i Komunës përkatëse;

1.5. *Qiraja në pronën bujqësore (C)*: kriter tjetër për vënien e çmimit të qirasë në pronën bujqësore duhet të jetë klasifikimi i tokës. Ky klasifikim duhet të bëhet sipas klasifikimit të tokës të bërë në Fletën Poseduese të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale (nuk përfshin institucionet paralele).

1.6. *Përshtatja sipas gjendjes fizike (D)*: nëse konstatohet që prona është në gjendje të rëndë gjatë Inspektimit të Pronës dhe siç tregohet nga fotografitë dhe përshkrimi, është e zbatueshme zbritja prej 25% nga çmimi i qirasë. Nëse prona bujqësore përmban një sistem ujitjeje të shfrytëzueshëm, vlera e qirasë të pronës duhet të rritet për 25%;



*1.7. Të ardhurat vjetore në investim (E):* kjo llogaritet çdo vit dhe është interesi mesatar mujor të cilin bankat në Kosovë e paguajnë për depozita ekuivalente me vlerën e pronës; (Pronat bujqësore përjashtohen);

*1.8. Zhvlerësimi fizik i vlerës kapitale të pronës (F):* ky është zvogëlimi i vlerës së pronës në baza mujore dhe kalkulohet vjetërsia e një prone, e cila është mesatarisht 80 vjet; (Pronat bujqësore përjashtohen);

*1.9. Mungesa e shërbimeve të pronarit (G):* pronat nën administrim janë pa shërbime të zakonshme të pronarit siç është mirëmbajtja e vazhdueshme, prandaj zbritja prej 10% nga qiraja është e zbatueshme për të gjitha pronat (Pronat bujqësore përjashtohen);

*1.10. Kalkulimi i qirase behet ne baze mujore.* (Pronat bujqësore përjashtohen).

2. Agjencia në emër të shepenzimeve të shërbimeve i mban 10% nga shuma e qirasë për të gjitha kontratat.

## **Neni 14**

### **Pronat nën administrim të trashëguara nga mandati i Drejtorise DCPB ( vazhdueshem)**

1. Për pronat nën administrim dhe skemë të qirasë, të vendosura nën administrim nga mandatet e trashëgara, aplikohen dispozitat e njëjta, sikurse për rastet tjera nën administrim dhe skemë të qirasë;

2. Agjencia është e obliguar që para kthimit të posedimit të pronës të verifikojë dokumentet e pronësisë, të të drejtës banesore apo të shfrytëzimit si dhe vendimin e trashëgimisë, varësisht siç mund të jetë rasti, të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës për posedim;

3. Me rastin e kthimit të posedimit Agjencia duhet të sigurohet se nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë nga ana e ndonjë organi administrativ apo gjyqësor, në lidhje me vërtetimin apo kthimin e të drejtës pronësore, banesore apo të shfrytëzimit;

4. Njësi i administrimit të pronave duhet të udhëheqë dhe monitorojë kthimin e posedimit të pronës dhe shumë së qirasë së grumbulluar, pas verifikimit të dokumenteve sipas paragrafit 3 më lartë;

5. Me kthimin e posedimit apo edhe qirave eventuale të grumbulluara, Agjencia nuk konfirmon asnjë të drejtë pronësore, banesore apo të shfrytëzimit, për parashtruesin e kërkesës për riposedim dhe pranuesin e shumës së qirave të grumbulluara;

6. Parashtruesi i kërkesës për riposedim, duhet të njoftohet në lidhje me efektin juridik të kthimit të posedimit, si dhe me pasojat eventuale juridike, të privimit të jashtëligjshëm nga e drejta pronësore, nëse pretendimet edhe dokumentet e parashtruara nuk janë të vërtetat.

## **Neni 15**

### **Ndërpreja dhe pezullimi i administrimit në lidhje me vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore**

1. Agjencia do të ndërpresë administrimin në të gjitha rastet kur parashtruesi i kërkesës për administrim, kërkojnë ndërprerjen përmes kërkesës për mbyllje apo kërkesës për riposedit;
2. Administrimi do të ndërprehet në të gjitha rastet kur prona është shitur tek një palë e tretë, ndërsa kontrata e shitblerjes është verifikuar pozitivisht nga Agjencia, apo shitblerja është konfirmuar nga ana e bartësit të të drejtës pronësore, parashtruesit të suksesshëm të kërkesës, antarëve të ngusht të familjes dhe trashëgimtarëve;
3. Në rast se bartësi i të drejtës pronësore, banesore, apo të shfrytëzimit ka vdekur, dhe nga ana e parashtruesit të kërkesës apo antarëve të ngusht të familjes Agjencia njoftohet se ka lindur një kontest apo është iniciuar një kontest në lidhje me trashëgimin, atëherë njësitit i administrimit do të ndërpresë administrimin, për çfarë do të njoftojë palët në procedurë;
4. Administrimi do të ndërprehet në të gjitha rastet kur prona e administruar është shpronësuar;
5. Agjencia do të pezullojë administrimin e pronës, në rast se prona është shitur pa vullnetin e bartësit të të drejtës pronësore apo trashëgimtarëve, ndërsa Agjencia është njoftuar se është filluar një procedurë penale apo civile, për ndëkje penale të kryerit të shitjes apo anulim të kontratës;
6. Administrimi do të pezullohet, në lidhje me çfarëdo veprimi apo kërkesë që ndërlidhet me qështje të sigurisë, shëndetit publik apo veprimeve tjera me interes publik dhe shtetëror, e që ndërlidhen me lokacionin ku gjendet prona apo me vetë pronën nën administrim.

## **Neni 16**

### **Ndërpreja dhe pezullimi i administrimit në lidhje me vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore**

1. Përmes kërkesës për riposedit dhe kërkesës për mbyllje, ndërprehet administrimi i kërkesave, në lidhje me vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, ndërsa njësitit i administrimit udhëheqë dhe mbikëqyr procesin e kthimit të posedimit apo mbylljes;
2. Administrimi i pronës banesore do të ndërprehet në të gjitha rastet kur objekti banesore apo shtëpia është demoluar nga ana e një institucioni lokal apo qendror;
3. Administrimi i pronës banesore do të ndërprehet në të gjitha rastet kur parashtruesi i suksesshëm i kërkesës ka vdekur, ndërsa antarët e ngusht të familjes njoftojnë se ka lindur një kontest ose është iniciuar një kontest në gjykatën kompetente në lidhje me trashëgimin;
4. Në të gjitha rastet kur Agjencia njoftohet se parashtruesi i suksesshëm i kërkesës ose cila do palë e autorizuar sipas ligjit ka parashtruar kërkesë për blerje të banesës sipas legjislacionit në fuqi,

ndërsa organi kompetent ka refuzuar blerjen dhe po ashtu me vendim të plotfuqishëm të gjykatës i është refuzuar blerja, atëherë Agjencia do të ndërpresë administrimin e pronës;

5.Në të gjitha rastet kur Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore ka referuar çështje të caktuara në gjykatat kompetente, ndërsa palët njoftojnë se është filluar procedura pranë gjykatës, atëherë Agjencia mund të pezullojë administrimin e pronës;

6.Në të gjitha rastet e kërkesave, kur me vendim të plotfuqishëm të gjykatave, është vendosur për një çështje e cila nuk ka qenë objekt i shqyrtimit nga ana e Komisionit, atëherë Agjencia mund të ndërpresë administrimin.

### **Neni 17**

#### **Dispozita kalimtare**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, për të gjitha pronat të cilat kanë qenë nën administrim para hyrjes në fuqi të ligjit 05/L-010 për AKKVP-në, Agjencia do të vazhdojë me administrim dhe skemë të qirasë pas konfirmimit të palëve duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion të Agjencisë.

### **Neni 18**

#### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Udhezimi Administrativ (QRK) Nr.07/2017 për Procedurat, Kushtet dhe Kriteret rreth Përfundimit të Administrimit të Pronave nën Administrimin dhe atyre të përfshira në Skemën e Qirasë të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

### **Neni 19**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Albin Kurti

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

05 Janar 2023